

## **Z. Sokol Cuni**

Në përgjigje të kërkesës tuaj, me nr. 3498 prot., datë 1.06.2021, me anë të së cilës keni kërkuar informacion në formë shkresore, për aktet ligjore dhe nënligjore, të cilave i referohemi për caktimin e pensionit suplementar të pleqërisë, bashkëlidhur do të gjeni:

- Ligjin nr. 10142, datë 15.05.2009, (ndryshuar me VGJK nr. 33, datë 24.06.2010) (ndryshuar me Aktin Normativ nr. 5, datë 10.11.2010), (Ligji 102/2016) “Për sigurimin shoqëror suplementar të Ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të Punonjësve të Policisë së shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të Punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë”;
- VENDIM nr. 793, datë 24.09.2010 (ndryshuar me VKM nr. 252, datë 09.02.2011) (i azhurnuar) Për zbatimin e Ligjit nr. 10142, datë 15.5.2009 “Për sigurimin shoqëror suplementar të Ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të Punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të Punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë”;

Në këtë kuadër, ju informojmë se në zbatim të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” dhe në përputhje me Programin e Transparencës ndaj Publikut, Instituti i Sigurimeve Shoqërore, në faqen zyrtare të internetit [www.issh.gov.al](http://www.issh.gov.al), ka publikuar të gjitha informacionet, që lidhen me funksionimin e skemës së sigurimeve shoqërore, Ligjet, VKM-të, raportet statistikore, etj, të aksesueshme për publikun.

Në këtë faqe mund të gjeni të publikuara, sipas rubrikave të veçanta, aktet ligjore dhe nënligjore, të cilat garantojnë përfitimet suplementare për: Ushtarakët e Forcave të Armatosura, Punonjësit e Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit të Punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë.